# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-437314**

VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | ‘Siguria kibernetike’ do mësohet për herë të parë në shkolla, lëndë më zgjedhje për klasat e para, të gjashta e të dhjeta |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sociale/siguria-kibernetike-do-mesohet-per-here-te-pare-ne-shkolla-lende-me-zgje-i585475` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 17:21:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 17:20:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `26ca3f3342f0d1f7fdc18c79ac31fe64442398a7e5ee923aee33b801bfb25df5` |
| TEKSTI | `587c65aaaae8001c35781f1cdf25bf78d9dee4e140fad584e41f8e201783967b` |
| PAMJA | `423c1bbfc9bf99b77dc9f306b31662a52b4c73e8cde1cf8d637c2bed225674ad` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b506a8578be4455c4ab8de620e922a9c491fe0a221c460d92ca1d35925e98a7e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b506a8578be4455c4ab8de620e922a9c491fe0a221c460d92ca1d35925e98a7e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# ‘Siguria kibernetike’ do mësohet për herë të parë në shkolla, lëndë më zgjedhje për klasat e para, të gjashta e të dhjeta

11 Shtator 2026, 19:20Sociale TEMA

‘Siguria kibernetike’ do mësohet për herë të

Fëmijët do të mësojnë në shkollë se si të mbrohen nga rreziqet e botës virtuale. Me nisjen e vitit të ri shkollor, siguria kibernetike do të përfshihet për herë të parë në programet e arsimit parauniversitar. Mësimi do të jetë me zgjedhje për klasat e para, të gjashta dhe të dhjeta në të gjitha shkollat e vendit.

“Kërcënime që kanë të bëjnë me bullizmin kibernetik, kërcënime që kanë të bëjnë me identitetin online, me vjedhjen e identitetit,  me rënien në kontakt të përmbajtjes së papërshtatshme për këtë grupmoshë ose me rënien në kontakt të personave ë të rrezikshëm”, tha drejtori i AKSK, Bledar Kazia.

Kurrikulat do të përfshijnë njohuri të përgjithshme se si fëmijët duhet të mbrojnë të dhënat dhe identitetin e tyre online dhe si të reagojnë.

“Çfarë duhet të kenë kujdes duke filluar që nga informacioni që ato ndajnë online që nga dallimi i një përmbajtje reale nga një përmbajtje ë jo reale. Kjo duke marrë shkas edhe nga përdorimi në masë i inteligjencës artificiale kohët e fundit.  gjithashtu me kë duhet të flasin në rast se kanë problematika ose hasin bullizëm kibernetik”, theksoi drejtori i AKSK, Bledar Kazia.

Për të garantuar që këto njohuri të përcillen siç duhet, do të trajnohen edhe mësuesit. Ata do të mësojnë si të reagojnë kur një nxënës raporton një rast abuzimi apo problematikë në hapësirën dixhitale.

“T'i trajnojnë se si duhet ta kenë qasjen në momentet kur një fëmijë ankohet ose paraqet përpara tyre një rast abuzimi në hapësirën dixhitale të çfarëdolloji qoftë ai, në mënyrë që ë mësuesit t'ia transmetojnë fëmijëve gjatë orarit mësimor dhe do vazhdojë e njëjta gjë edhe me prindërit në mënyrë që prindërit t'ua transmetojnë fëmijëve gjatë periudhës që ato janë jashtë ambienteve shkollore”, tha drejtori i AKSK, Bledar Kazia.

Vetëm gjatë vitit të kaluar, në Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike janë raportuar 240 raste abuzimi online.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Siguria kibernetike, për herë të parë lëndë mësimore]

17:20 Sociale / 1 koment

[Banorët akuza "Bankers": Nuk na kanë paguar qiranë e tokës]

16:30 Sociale / 1 koment

[Bie numri i maturantëve, por rritet ai i studentëve të rinj]

16:20 Sociale / 1 koment

[Inspektorët me kamera inteligjente, Dash Sula: Kontrollet do të përcaktohen nga sistemi i ri, qytetarët të denoncojnë]

15:50 Sociale / 1 koment

[Ministri Salla: Siguria ushqimore e fëmijëve, pa kompromis. AKU intensifikon kontrollet me nisjen e vitit shkollor]

15:33 Sociale

[88 nxënës fitues të olimpiadave vlerësohen në Kryeministri, Rama: Jeni frymëzim! Mos u dorëzoni dhe mos e tradhtoni kurrë ëndrrën që keni]

15:35 Sociale

[Vlerësohen 88 olimpiadistë, Kumbaro: Ju jeni prova që s'mund të vareni nga teknologjia, por ta keni në duart tuaja për të zhvilluar mendimin kritik]

14:59 Sociale

[Rregullorja censuruese e GJKKO-së shkon në Kushtetuese, gazetarët padi të hënën: Të pezullohet deri në marrjen e një vendimi]

14:12 Sociale / 1 koment

[Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës investon 2 milionë euro në 46 mjete të reja për operimet në pistë]

13:45 Sociale / 2 komente

["Fond kombëtar për strehimin" - Ibrahimaj: 7 mijë apartamente për shtresat në nevojë. Subvencionim qiraje për 3 mijë banesa]

11:20 Sociale

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**["Berisha gënjeu demokratët" - Bejko: Nuk ka më të drejtën...]**

09:45 Politika / 23 komente

**[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...]**

15:45 Politika / 30 komente

**EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej "aferën e armëve" m...**

15:30 Dossier / 13 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 51 komente

**'Kallëzim se po zbatoj ligjin', ministri Malaj publikon p...**

19:05 Politika / 77 komente

## Blog Tema

**Mbrojini fëmijët nga shkolla**

18:00 Blog / 1 koment

**A ka OSBE/ODIHR në Amerikë?**

17:40 Blog / 1 koment

**Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve**

13:50 Blog / 16 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.